



Në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 nen c) dhe d), nenit 40 paragrafi 40.2 nen a), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L040 publikuar në Gazetën Zyrtare nr.28/2008, dispozitat e nenit 10 te Statutit te Komunës së Klinës, Nr. 01-110-1232/2010 te miratuar më datën 31.03.2010, si dhe duke marre parasysh kërkesën me nr. 05-Nr.430-2746/2021 të datës 25.01.2021 nga drejtoria për FEZH dhe rekomandimin e KPF-së të datës 15.02.2021, Kuvendit të Komunës së Klinës në seancën e rregullt me datë 26.02.2021, merr:

V E N D I M

Për

Ndryshimin e Rregullores për Tarifat, Ngarkesat dhe Gjobat Komunale me Nr. 01Nr.434-1677/2019 të datës 25.04.2019

1. Ndryshohet Rregullorja për Tarifat, Ngarkesat dhe Gjobat Komunale, në Nenin 19 pika e fundit e këtij neni do të mbetet si në pikë 2 (dy) të këtij vendimi.
2. Si prova formale drejtoria përkatëse duhet ta pranoji, Vërtetimin e shlyerjes se biznesit nga Zyra e bizneseve.
3. Ky vendim do të jetë pjesë përbërëse e Rregullores për Tarifat, Ngarkesat dhe Gjobat Komunale
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset: Kryetari i Komunës në bashkëpunim më Drejtorinë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe organet tjera ndihmese.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës, ky vendim hynë në fuqi 15 dite pas delegimit në autoritetin mbikëqyrës në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, si dhe nenit 16 dhe 17 te Rregullores se MAPL nr.01/2017 Për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të komunave.

KUVENDI I KOMUNËS

01Nr. 06-7778 /2021
Klinë, datë 10/03/2021



Kryesuesi
Fadil Gashi

Të njoftohen:

- Kryetari;
- Drejtoria e Financave;
- MPL
- Arkivi.